



15.08. 17

REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO



**REPUBLICA E KOSOVËS**  
**REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT**  
**OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN**

KA.nr.49/11

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike Birsën Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarit, I. T nga fsh. , Komuna e Prizrenit për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 23 të KPK sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP.nr.2393/09 të datës 01.04.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Beqë Shala, akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.E. G. nga Prizreni me datë 20.03.2017 morri këtë

**AKT GJYKIM**

**Të akuzuarit:**

I. T., nga i ati I. dhe e ëma N., e lindur M., i lindur më në fsh. K e Prizrenit, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i martuar-babë i 7 fëmijëve, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me datën 27.05.2009, në Prizren, me qëllim për t' i sjellë vetes dobi pasurore e mashtrorinë dhe e sjellin personin tjetër në lajthim, me anë të paraqitjes së rreme, duke i fshehur faktet dhe e shtynjë që të veproj në dëm të pasurisë së tij të dëmtuarit B. B., në atë mënyrë që pasi paraprakisht merren vesh mes vete, ia ofrojnë e më pas ia shesin palujtshmërinë ( e huaj) të bashkëpronarëve si në dispozitivin nën I. të aktakuzës dhe ate parcelën kadastrale nr. P-71813023- në vendin e quajtur "B." në sipërfaqe prej 0.83.25 ha, të evidentuar në fletëposedimin nr. deri derisa e akuzuara e parë nënshkruan në gjykatë në emër të shitësve, kontratën e shitblerjes me të dëmtuarin-blerësin B. B., ndërsa të akuzuarit nën 2,3 dhe 4, pas vërtetimit të kontratës ndërmjetësojnë duke ia mundësuar të dëmtuarit rregullimin e dokumentacionit rreth bartjes në pronësi dhe posedim dhe në emër të shirblerjes, të akuzuarit nga i dëmtuari pranojnë shumën prej gjithsejt 35.000,00€ të cilën shumë më pas të akuzuarit e ndajnë mes vete sipas marrvëshjes së tyre.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 23,41,43,45,73, 74, 75 dhe 76 të KP-së dhe të nenit 261 par. 2 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 23 të KPK, të akuzuarit I, II, III, IV, V, VI dhe VII gjykon me:

### DËNIMIN ME BURGIM

**Në kohëzgjatje prej 8 ( tetë) muajve.**

I dëmtuari B. ... për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik.

Obligohet i akuzuari që sipas llogarisë së gjykatës të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren ka parashtruar Aktakuzë - PP.nr.2393/09 me datë 01.04.2011, në lëndën penale kundër të akuzuarve: Z. ... S. ... nga fsh. ... Komuna Shtërpçe, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve publike nga neni 332 par.3 lidhur me par. 1 të KPK, dhe veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 lidhur me 1 lidhur me nenin 23 të KPK dhe A. ... V. ... nga Prizreni, I. ... T. ... nga fsh. ... Komuna e Prizrenit dhe Sh. ... A. ... nga Prizreni, për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 23 të KPK.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhënë shqyrtime në të cilat nuk ka mund të sigurojë prezencën e të akuzuarëve të lartëcekur dhe ndaj tyre ka lëshuar urdhërarrest të hapur. Me dt. 20.03.2017, nga ana e Policisë së Kosovës në gjykatë është sjellur i akuzuari I. ... T. ... , ndërsa nuk është siguruar prezenca e të akuzuarëve të tjerë Zhi. ... S. ... A. ... V. ... dhe Sh. ... A. ... I akuzuari I. ... T. ... dhe avokati i tij mbrojtës kanë propozuar veçimin e procedurës ndaj të njëjtit ku këtë propozim nuk e ka kundërshtuar prokurori i shtetit andaj gjykata për hir të ekonomizimit të kësaj procedure e bëri veçimin e procedurës sa i përket dispozitivit nën II. të aktakuzës ku si i akuzuar figuron I. ... T. ...

Duke vepruar sipas Aktakuzës PP.nr.2393/09 të datës 01.04.2011, në shqyrtimin fillestar gjyqësor i akuzuarit I. ... ka pranuar fajësinë për veprën penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 23 të KPK.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin ka vërtetuar këtë gjendje faktike:



Se me datën 27.05.2009, në Prizren, me qëllim për t' i sjellë vetes dobi pasurore e mashtrinë dhe e sjellin personin tjetër në lajthim, me anë të paraqitjes së rreme, duke i fshehur faktet dhe e shtynë që të veprojnë në dëm të pasurisë së tij - të dëmtuarit B. E. në atë mënyrë që pasi paraprakisht merren vesh mes vete, ia ofrojnë e më pas ia shesin palujtshmërinë ( e huaj) të bashkëpronarëve si në dispozitivin nën I. të aktakuzës dhe atë parcelën kadastrale nr.

P-71813023-C në vendin e quajtur "B..." në sipërfaqe prej 0.83.25 ha, të evidentuar në fletëposedimin nr. 718... derisa e akuzuara e parë nënshkruan në gjykatë në emër të shitësve, kontratën e shitblerjes me të dëmtuarin blerësin B... ndërsa të akuzuarit nën 2,3 dhe 4, pas vërtetimit të kontratës ndërmjetësorë duke ia mundësuar të dëmtuarit rregullimin e dokumentacionit rreth bartjes në pronësi dhe posedim dhe në emër të shitblerjes, të akuzuarit nga i dëmtuari pranojnë shumën prej gjithsej 35.000,00€ të cilën shumë më pas të akuzuarit e ndajnë mes vete sipas marrveshjes së tyre.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin fillestar gjyqësor vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.


Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila u vihet në barrë e që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime. Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale.

Gjykata erdhi në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, ku në veprimet e të akuzuarit... formohen të gjitha elementet e veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 23 të KPK për të cilën vepër të akuzuarin shpalli fajtor dhe e gjykoi me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 muajve.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimin, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar është e vërtet që ka ndodhur rasti si në aktakuzë, për të cilin gjë ai është penduar dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër të ngjashme penale.

Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarëve u shqiptoi sanksionin gjyqësor penal sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksioni shqiptuar i



përgjigjet shkallës së përgjegjësise penale juridike të t tyre dhe se me këtë sanksion do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike, gjykata mori në kuptim tënenit 463 të KP.


Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
KA.nr.49/11 datë 20.03.2017

Sekretare Juridike  
Birsen Shoshani

Gjyqtarja  
Shpresa Emra



**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimt të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.